

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**

PRISHTINË

**Lënda: E DREJTA E SIGURIMIT SOCIAL**  
**NDËRKOMBËTAR**

*Studime :Bachelor*

*Lëndë: Zgjedhore*

*Viti i studimeve dhe semestri: Viti i III-të, semestri i V-të*

*Kodi dhe shifra e lëndës:\_\_\_\_\_*

*Vlera në kredi – ECTS: 5*

*Lokacioni i mbajtjes së ligjëratave:Salla S/3*

*Mësimdhënësi i lëndës: Dr.sc.Hava Bujupaj-Ismajli,prof.ass. Kabineti nr.11.*

*Email zyrtar; [hava.ismajli@uni-pr.edu](mailto:hava.ismajli@uni-pr.edu).*

*Ma. sc. Ass. Muhamet Vokrri; [muhamet.vokrri@uni-pr.edu](mailto:muhamet.vokrri@uni-pr.edu).*

*Adresa e postës elektronike: Email-[havaismajli@hotmail.com](mailto:havaismajli@hotmail.com)  
Tel:044-655-400.*

**Termini për konsultime me studentë: E martë, E mërkurë, E enjte, prej orës 12:00 – 14:00.**

### ***Viti akademik 2018***

1. **Qëllimi i lëndës mësimore:** Njoftimi, përgatitja dhe aftësimi i juristeve të ardhshëm, sidomos të atyre që do të punojnë në institucione, që i referohen fushës sociale, që të zbatojnë metodat më të përshtatshme dhe më adekuate për zgjidhjen e problemeve nga kjo fushë. Këto metoda do të mund t'i zbatojnë qoftë me rastin e hartimit të ligjeve nga kjo fushë, por edhe me rastin e përdorimit apo huazimit të ligjeve nga vendet e tjera, duke ua përshtatur vendit tonë dhe kërkesave të kohës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të ligjëratave nga kjo lëndë, studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të të dijë t'i interpretoj dhe aplikoi Dispozitat juridike nga kjo fushë:
2. Të jetë i gatshëm për peregaditjen e programeve sociale, me qëllim të zbutjes së gjendjes sociale:
3. Të përdor metodat më adekuate me qëllim të ndërtimit të një sistemi adekuat të sigurimit social etj.
4. Të jetë i aftë për kategorizimin e shtresave sociale, në mënyrë që t'iu afrohet ndihma e duhur apo mbrojtja sociale:
5. Të shfrytëzoj njohuritë teorike me qëllim të zbutjes së varfërisë gjë e cila do të ketë ndikim në rënien e kriminalitetit dhe të dukurive të tjera negative të shoqërisë:

Metodologjia e mësimdhënies: - Në pjesën më të madhe të kohës do të mbahen **Ligjëratat Interaktive**, që d.m.th. përveç ligjërimit të mësimdhënësit, kyqen edhe studentët, qoftë me prezantime, qoftë me pyetje apo diskutime lidhur me çështjet tematike që janë objekt i trajtimit në ligjëratë.

**Punimet seminarike**, studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë, për punim seminarik para fillimit të punës, atyre

iu epen udhëzime se si duhet të përgatitet punimi seminarik. Punimin seminarik studenti duhet t'ia dorëzoj mësimeve, i cili e kontrollon dhe pas kontrollimit hapën diskutime me studentë lidhur me temën e seminarit.

Ushtrimet me grupe më të vogla – gjatë mbajtjes së ushtrimeve studentëve do t'iu mundësohet që të jenë më aktiv si dhe t'iu shprehin opinionet dhe idetë e tyre për zgjidhjen e çështjeve nga fusha sociale.

Literatura bazë: Llambro Filo: Historia për shtetin e mirëqenies Sociale, Tiranë,2006.

Zhan Pjer Labord, E drejta e Sigurimit Social.

Dr.Hava Bujupi-Ismajli,E drejta Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë 2001.

Lex Legis, nga Mirëqenia Sociale, Analizë strukturore dhe ligjore nga Ma. sc. Muhamet Vokri, Nëntor, 2011.

## **PLAN I MËSIMOR**

### **I ligjëratave dhe ushtrimeve i detajuar për javë dhe orë**

#### JAVA E PARË

- Njohuritë e përgjithshme mbi shtetin e mirëqenies sociale.
- Koncepti i sotëm i shtetit të mirëqenies sociale.
- Karakteristikat e shtetit të mirëqenies sociale.
- Përcaktimet e personaliteteve shtetërore për shtetin e mirëqenies sociale:
- Tiparet thelbësore të shtetit të mirëqenies sociale;

## JAVA E DYTË

- Komponentët e shtetit të mirëqenies sociale:
- Sigurimet sociale.
- Sigurimi social sipas klasifikimit ndërkombëtar:
- Mirëqenia:
- Mekanizmat ekonomik të shtetit të mirëqenies sociale;

## JAVA E TRETË:

- Faktorët ndikues në shtetin e mirëqenies sociale:
- Faktori demografik:
- Faktori ekonomik:
- Faktori politik:
- Faktori i jashtëm (ndërkombëtar):

## JAVA E KATËRT:

- Çështjet e përgjithshme dhe nocionet bazë të sigurimit social:
- Nocioni dhe objekti i sigurimit social:
- Origjina dhe zhvillimi i sigurimit social;
- Sigurimi social në shtetet me sisteme juridike bashkëkohore:

## JAVA E PESTË:

- Politika sociale:
- Faktorët e politikës sociale
- Modelet e politikës sociale:
  1. sistemi modern liberal (SH.B.A.)
  2. Modeli social demokratik (Suedi)
  3. Modeli modern konservativ (Gjermani)

## JAVA E GJASHTË:

- Burimet e së drejtës së sigurimit social:
- Dispozitat shtetërore si burime të së drejtës së Sigurimit social:
  1. Kushtetuta;
  2. Ligji;
  3. Aktet nënligjore;
- Burimet autonome të së drejtës së sigurimit social;
- Burimet e të drejtës së sigurimit social me origjinë ndërkombëtare:

## JAVA E SHTATË:

- Do të bëhet vlerësimi i parë me shkrim përmes kollokfiomit i cili do të përmbajë 10 pyetje që kryesisht do t'i referohen ligjëratave të mbajtura deri në javën e shtatë.

## JAVA E TETË:

- Parimet e së drejtës së sigurimit social:
- Parimi i obligueshmërisë dhe vullnetarizmit:
- Parimi i solidaritetit dhe i reciprocitetit:
- Parimi i demokratizimit dhe participimit të siguruarit në qeverisje.

## JAVA E NËNTË:

- Sigurimi shëndetësor dhe mbrojtja shëndetësore:
- Parimet e sigurimit shëndetësor dhe të mbrojtjes shëndetësore:
- Të drejtat nga sigurimi shëndetësor:

- Mbrojtja shëndetësore:

### JAVA E DHJETË:

- E drejta në mbrojtjen shëndetësore:
- E drejta në sigurime shoqërore:
- E drejta për asistencë sociale dhe mjekësore:
- E drejta e familjes për mbrojtjen sociale juridike e ekonomike:
- E drejta e nënës dhe fëmijës për mbrojtjen sociale dhe ekonomike:

### JAVA E NJËMBËDHJETË:

- Mbrojtja nga papunësia:
- Sistemet e mbrojtjes nga papunësia:
- Sistemi i obliguar i mbrojtjes nga papunësia:
- Sistemi i mbrojtjes nga papunësia që organizohet nga ana e Sindikatës:

### JAVA E DYMBËDHJETË:

- Mbrojtja e fëmijëve:
- Kujdesi, strehimi, edukimi dhe shkollimi
- Pushimi i organizuar dhe rekreacioni:
- Shtesat e fëmijëve:
- Ndiurma afatshkurtër për përgatitjen e fëmijës së porsalindur etj.

( nga përvoja dhe praktika e vendeve të ndryshme )

### JAVA E TREMBËDHJETË

- Do të bohet vlerësimi i dytë intermediatik përmes Kollokfiumit i cili do të përmbajë 15 pyetje që kanë të bëjnë me çështjet e ligjëratave të mbajtura paraprakisht.

### JAVA E KATËRMBËDHJETË:

- Globalizimi i jetës sociale:
- Pasojat ekonomike të kolonializmit:
- Varfëria:
- Divergjencat midis vendeve të pasura dhe të varfra:
- Lidhjet midis botës së parë dhe botës së tretë:

### JAVA E PESËMBËDHJETË:

- Problemet me të cilat përballen shtetet e mirëqenies sociale:
- Rritja e globalizimit ekonomik:
- Ndërvarësia ekonomike botërore:
- Teknologjia e sofistikuar:
- Lidhja e ndërthurur dhe shumë e madhe e arsimit-shkencës-teknologjisë-punësimit-marketingut;

#### Metodat e Vlerësimit:

Për vlerësimin e studentëve nga lënda E drejta e Sigurimit social, mësimdhënësja do të ketë në konsideratë këto kritere:

-Vijimi i rregullt në ligjërata	_____	5-10%
- Vlerësimi i parë me shkrim (kollokfium)	_____	5-10%
- Vlerësimi i dytë me shkrim (kollokfium)	_____	5-10%
- Punimi seminarik	_____	10-20%
- Provimi final	_____	50 %

## Politika akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët gjatë ligjëratave, provimeve, por edhe pranisë së tyre në fakultet, duhet t'i përmbahen rregullave si më poshtë:

- mos ta pengojnë procesin mësimor
- t'i respektojnë mësimdhënësit.
- Mos të përdorin pije, goma përtpyse, duhan, në sallë të mësimi.
- Ti ç'kyçin telefonat celular, gjatë ligjëratave dhe provimeve.
- Mos të kopjojnë gjatë mbajtjes së provimeve dhe testimeve.
- Të respektojë dispozitat e kodit të etikes, hyrë në fuqi në Tetor të vitit 2009, e të hartuar në bashkpunim me ABA-Rollin dhe USAID.

## Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. *Kval – Mellby –Tranoy, - Politika dhe Demokracia, Prishtinë 2006.(Përkthim në gjuhën shqipe ).*
2. *Zhan Pjer Labord, E drejta e sigurimit social, 2011.*
3. *Anthony Giddens, Sociologjia (përkthim në gjuhën shqipe), Tiranë, 2004.*
4. *Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat ekonomike, kulturore dhe shoqërore , 1966.*
5. *Karta Sociale Evropiane e ndryshuar, 1999.*